

Rritja e Efikasitetit në Menaxhimin e Mbeturinave përmes *ndreqe.com*



Nëntor, 2018
Prishtinë, Kosovë

Rritja e Efikasitetit në Menaxhimin e Mbeturinave përmes *ndreqe.com*

Përgatitur nga: **Jetmir Bakija**



DEMOCRACYPLUS

E drejta e autorit ©2018. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.



PËRMBAJTJA

I. Hyrje	6
II. ndreqe.com si mjet për mirëmbajtje të ambientit	7
III. Raportimi dhe largimi i deponive ilegale	9
Në Nivel Vendi	9
Sipas Komunave	10
Kohëzgjatja e Reagimit të Komunës	14
IV. Sfidat e largimit të deponive ilegale	15
Menaxhimi dhe Administrimi	15
» Mungesa e Inspektorëve dhe Gjobave	15
» Mbulueshmëria Jo e Plotë me Shërbim	16
» Resurset Administrative për Menaxhim	17
Kontraktimi për Largimin e Deponive	17
» Kapacitetet e Ndërmarrjeve Publike	17
» Kontratat me Kompani Private	18
» Mungesa e Buxhetit	18
» Lokacionet e Caktuara për Transportim	20
V. Organizimi për Intervenim të Shpejt mbi Raportimet	21
VI. Përpilimi i kontratave me kushte për intervenim të shpejt	23
VII. Rekomandimet	25
Ekipet e Reagimit të Shpejt për Raportime të Qytetarëve	25
Përpilimi i Kontratave me Kushte për Intervenim të Shpejt	25
Përpilimi i Kontratave duke u Bazuar në Evidenca të Raportimeve në ndreqe.com	25
Planifikimi i Buxhetit të Veçant për Largimin e Deponive	25
VIII. Anekset	26
Aneks I: Numri i Deponive të Larguara sipas Muajit	26
Aneks II: Shkalla e Largimit të Deponive sipas Komunave	26
Aneks III. Deklarimet e Zyrtarëve Komunal për ndreqe.com	27
Aneks IV. Kriteret e Kontratës nga Komuna e Podujevës	29
Aneks V. Kriteret e Kontratës nga Komuna e Obiliqit	30

I. Hyrje

Teknologjia e Shekullit XXI paraqet mundësi tejet të mëdha për t'i afruar qytetarët me qeveritë e tyre për një të mirë të përbashkët publike, një element kyç në sistem demokratik. Nëse gjen përdorimin e duhur mund të lehtësoj punët e zyrtarëve publik dhe të rris efikasitetin e tyre. Mirëpo, jo rrallë herë teknologjia e re gjen rezistencë për shkak të frikës së ndryshimeve që sjell dhe për shkak të besueshmërisë. Në këto raste, nuk merret guximi të shfrytëzohet potenciali i saj. Për shërbime publike, teknologjia informative është një mjet që mund të transformoj ofrimin e shërbimeve dhe ky mjet po shfrytëzohet çdo ditë e më shumë në vende kudo në botë.

Me këto qëllime në mendje është zhvilluar edhe platforma ndreqe.com. Rritja e efikasitetit në ofrim të shërbimeve publike dhe lehtësimi i komunikimit dy kahor, zyrtarë – qytetarë, janë baza e kësaj platforme. Por si çdo gjë tjetër në botë, ky mjet tregon rezultat dhe përvetësohet vetëm nëse merret guximi të përdoret dhe shërbej si një nga mjetet e punës për ofrim të shërbimeve.

Tek menaxhimi i mbeturinave, e cila mbetet një nga sfidat më të mëdha në Kosovë, platforma ndreqe.com krijon mundësi për të kyçur publikun në raportimin e deponive ilegale të mbeturinave, identifikimin e nevojave për shtrirje më të mirë të shërbimeve dhe parandalimin e krijimit të deponive ilegale të reja. Sfidat e menaxhimit të mbeturinave janë të shumta si pambulueshmëria e plotë e territorit me shërbim për mbledhje të mbeturinave, niveli jo i kënaqshëm i pagesave për shërbime, kapacitetet e pamjaftueshme të ndërmarrjeve publike, mungesa e buxhetit, mungesa e inspektorëve dhe gjobave për abuzime, kapacitetet e deponive legale të mbeturinave dhe sfidat në funksionimin e zinxhirit për menaxhimin e mbeturinave. Të gjitha këto nuk mund të adresohen me një mjet si ndreqe.com dhe asnjë teknologji tjetër në botë. Mirëpo, janë disa aspekte të rëndësishme të menaxhimit të mbeturinave për të cilat një platformë si ndreqe.com mund të ndihmoj dhe lehtësoj punën.

Për largimin e deponive ilegale të mbeturinave si dhe ndalimin e krijimit të deponive të reja, platforma ndreqe.com mund të jetë mjaft e përdorshme për shkak se mund ta transformoj çdo qytetarë në inspektorë për komunën dhe ta ngrit llogaridhënien e kompanive kontraktuese ndaj komunës. Ka zëra që thonë që largimi i deponive aktuale dhe ato që mund të krijohen nuk është problemi më i madh i menaxhimit të mbeturinave për shkak se nëse nuk adresohen sfidat tjera, deponitë e larguara mund të rikrijohen me kohë. Mirëpo nuk është arsyejm që ato të lihen ashtu dhe të kemi ambient të papastër. Nga komunat pritet që t'a largojnë, pastrojnë, rregullojnë dhe gjelbërojnë vendin dhe të marrin masa parandalimi me institucionet përgjegjëse.

Kjo analizë e politikave publike, në pjesën e parë, shtjellon mundësitë që ofron një platformë që bazohet në teknologji informative të sofistikuar si ndreqe.com në ofrimin e shërbimeve publike në nivel komunal, në veçanti për menaxhimin e mbeturinave, dhe jep një pasqyrë të raportimeve qytetare të deponive ilegale të mbeturinave si dhe ndërhyrjet e komunave për të adresuar ato raportime bazuar në të dhëna një vjeçare. Ndërsa në pjesën e dytë, kjo analizë sugjeron si të përmirësohet organizimi i administratës për të intervenuar më shpejt pas raportimeve të qytetarëve si dhe si të përpilohen kontrata më adekuate për pastrimin e deponive ilegale për mbeturina.

Përmirësimet në këto dy aspekte të menaxhimit të mbeturinave, apo çfarëdo ofrimi të shërbimeve tjera, e ngrit efikasitetin e ofrimit të shërbimeve dhe e ngrit komunikimin e institucioneve



komunale me banorë të komunës të cilët e ka për qëllim t'iu shërbej.

II. *ndreqe.com* si mjet për mirëmbajtje të ambientit

Një nga përgjegjësitë më të rëndësishme që ka një qeveri lokale është ofrimi i shërbimeve publike për banorët e asaj komune. Qytetarët presin që shërbimet publike si mbledhja e mbeturinave, mirëmbajtja e ambientit të pastër, rrugët, trotualet e ndriçimi të jenë në gjendje të mirë. Për atë edhe paguhen taksat lokale dhe dalin në votime për të zgjedhur më të mirin për të ofruar këto shërbime.

Mirëpo shpesh është vështirë që kërkesat e qytetarëve për këto shërbime të identifikohen, evidencohen, procesohen e kanalizohen për adresim nga zyrtarët komunal. Madje komunikimi individualisht me qytetarë për kërkesat e tyre pas reagimit të zyrtarëve komunal bëhet pothuajse i pamundur. E ky lloj komunikimi është tepër më rëndësi pasi shpesh komunat e adresojnë një kërkesë por nuk e komunikojnë intervenimin tek qytetarët të interesuar për atë kërkesë.

Për këtë qëllim, ekziston platforma online *ndreqe.com*. Pra, që t'ia lehtësoj komunës të identifikoj dhe evidencoj kërkesat e qytetarëve për shërbime publike dhe t'a komunikoj adresimin e kërkesës tek qytetarët e interesuar individualisht. Jo rrallë herë qytetarët e kanë një përshtypje që komuna e tyre nuk i dëgjon kërkesat e tyre dhe se nuk ka interes t'i adresoj ato. Mirëpo, zyrtarët komunal në baza ditore punojnë që të rregullojnë punët me interes për qytetarët që u shërbejnë. *Ndreqe.com* ofron një mundësi të identifikoj kërkesat e tyre dhe të komunikoj ndërhyrjen dhe kërkesat e komunës.

Në rastin e një problemi madhor siç janë deponitë ilegale të mbeturinave, rëndësia e identifikimit, evidencimit dhe komunikimit të punës bëhet edhe më e rëndësishme. Për t'a pastruar Kosovën nga deponitë ilegale të mbeturinave duhet një organizim tejet i mirë nga komuna dhe nevojitet ndihma e qytetarëve, nëse jo në pastrim, së paku në identifikim dhe mirëmbajtje. Një platformë që përmban lokacionet e sakta të një pjese të madhe të deponive ilegale në hartë interaktive ku zyrtarët komunal mund të shohin deponitë në një lagje të caktuar apo rrugë të



caktuar, e lehtëson planifikimin e largimit të atyre deponive në kohën kur komuna është e gatshme të marrë aksion për të larguar ato. Përpos planifikimit për largim, një hartë interaktive e komunës me deponi ilegale të mbeturinave të evidencuar i ndihmon komunës të kuptoj madhësinë e problemit në komunë, planifikoj buxhetin adekuat si dhe të përpiloj kontratën për angazhimin e kompanive që do të pastrojnë ato lokacione.

Në anën tjetër, pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave sipas kërkesave të qytetarëve e mundëson komunikimin e punës së komunës në këtë aspekt edhe fuqizimin e besimit të institucioneve lokale.

Demokracia e mirëfilltë varet nga qytetarë të përgjegjshëm që angazhohen për të përmirësuar lagjet dhe komunitetin e tyre. Institucionet lokale duhet ta fuqizojnë këtë nocion në baza ditore. Raportimet e qytetarëve për kërkesat e lagjeve të tyre në ndreqe.com tregojnë që ata interesohen për ambientin e tyre, janë të përgjegjshëm pasi marrin kohën që së paku të evidencojnë problemin dhe tregojnë se kanë së paku një lloj besimi tek institucionet që do të ndërhyjnë për të ofruar shërbimin që ata kërkojnë. Kjo duhet të kultivohet edhe më shumë dhe platforma ndreqe.com është një mjet i mirë të ndihmoj në këtë drejtim.

Platforma është e ndërtuar për të mundësuar komunikimin e brendshëm në mes të zyrtarëve komunal dhe të mbajtjen e evidencave për ndërhyrjet e tyre mbi ankesat e qytetarëve si dhe të mundësoj komunikimin e jashtëm të institucioneve komunale për ankesat e raportuara.

Në fund të fundit, ky problem nuk mund të zgjidhet pa funksionuar bashkëpunimi (zinxhiri) komunë - ndërmarrje për mbeturina - qytetarë. Komuna duhet të ofrojë politika, resurse, inspeksion dhe mbikëqyrje të menaxhimit të mbeturinave, ndërmarrja e menaxhimit të ofrojë shërbimin sipas kërkesave të zyrtarëve komunës dhe pritjeve të qytetarëve, ndërsa qytetarët duhet të paguajnë dhe t'a ruajnë ambientin. Është shumë lehtë të hedhet faji në mes të këtij trekëndëshi dhe shpesh kjo bëhet shkaktar i mosveprimit. Shpesh dëgjojmë arsyetime nga ndërmarrjet se si nuk ka shërbim cilësor të mbledhjes së mbeturinave sepse qytetarët nuk paguajnë, apo qytetarët arsyetohen që s'po paguajnë sepse nuk po ka shërbim apo është jo-cilësor, apo komuna ankohet për ndërmarrje që nuk po e kryejnë punën dhe vetëm se kërkojnë fonde.

Qytetarët mund të jenë aseti më i madh për adresimin e problemit të deponive ilegale duke identifikuar ato deponi, duke identifikuar keqbërësit dhe duke u kthyer në mbrojtës të ambientit. Komuna mund t'i kthej qytetarët në inspektorë për deponi ilegale nëse dëshiron dhe di t'i angazhoj.

Ky në fakt është qëllimi i platformës ndreqe.com që e bënë të mundur këtë angazhim të qytetarëve dhe gjeneron një databazë dhe hartë që e lehtëson identifikimin. Nëse një komunë arrin që të angazhoj qytetarët në largimin e deponive ilegale dhe t'i kthej ata në partner të mirëmbajtjes së ambientit, atëherë problemi do të zgjidhet më lehtë dhe zgjidhja do të jetë më e qëndrueshme. Kjo është e dëshmuar në shumë komunitete në Angli ku qytetarët angazhohen përmes platformave online për të mirëmbajtur ambientin, jo vetëm të pastër nga mbeturinat por edhe nga probleme tjera si dëmtimi i pronës publike dhe grafiti.



III. Raportimi dhe largimi i deponive ilegale

Në Nivel Vendi

Platforma ndreqe.com përmban databazën më të madhe të deponive ilegale të mbeturinave në Kosovë¹. Kjo për faktin se përveç deponive të regjistruara nga vullnetarë të një aksioni të financuar nga GIZ, platforma për gati dy vite u ka mundësuar qytetarëve kudo në Kosovë që të raportojnë deponitë ilegale në lagjet e tyre. Për më tepër, platforma ndreqe.com mban databazën më të përditësuar sa i përket deponive të larguara nga komunat për shkak se u mundëson zyrtarëve komunal të përditësojnë gjendjen e deponive ilegale.

Madhësitë e deponive me mbeturina janë të ndryshme nga ato të vogla, kryesisht në vende urbane, në ato nga më të mëdhatë kryesisht në zona rurale (jashtë vendeve të banuara). Deri më tani në platformën ndreqe.com në të gjithë Kosovën janë të regjistruara gjithsej 2,119 deponi ilegale të mbeturinave të madhësive të ndryshme. Pjesa më e madhe e tyre, rreth 1,700 janë deponi mesatarisht të mëdha dhe kryesisht në zona rurale. Të tjerat janë regjistruar në zona urbane. Këto lokacione me deponi ilegale të mbeturinave janë të verifikuara së paku një herë gjatë këtij viti nga ekipi i ndreqe dhe zyrtarët komunal. Secila deponi ilegale është publike në ndreqe.com dhe për secilën mund të gjenden të dhënat në vijim: 1) lokacioni i saktë në hartën interaktive të komunës përgjegjëse dhe 2) së paku një foto se si duket lokacioni dhe madhësia e deponisë.

Inkurajuese është fakti se se 345 prej këtyre deponive janë të konfirmuara si të larguara dhe pastruara nga komunat e Kosovës. Në kohën e publikimit të këtij hulumtimi, si të pa larguara mbesin 1,798 deponi ilegale. Për më tepër komunat në vazhdimësi janë në largim

¹ Përveç deponive ilegale të mbeturinave, platforma ndreqe.com përmban edhe raportime të qytetarëve për gropa në rrugë, ndriçim të prishur, trotuar të dëmtuar, ujëra të zeza, shenja të dëmtuara dhe pengesa për persona me aftësi të kufizuar.

Figura 1:

Të gjitha deponitë ilegale të regjistruara në ndreqe.com





Figura 2:

Të gjitha deponitë ilegale të larguara nga komunat



e sipër edhe të deponive tjera të identifikuar në ndreqe.com dhe po i përditësojnë për publikun dhe për të mbajtur evidencat e tyre. Përpos këtij numri të identifikuar nga ndreqe.com (345), sigurisht që mund të jetë edhe ndonjë deponi tjetër e larguar por që nuk është përditësuar në platformë.

Ekipi i ndreqe.com si dhe zyrtarët komunal janë në vazhdimësi në verifikim dhe përditësim të databazës së ndreqe.com. Megjithatë, numri i deponive të papërditësuara nuk shkon mbi 10% të deponive që figurojnë në platformë. Kjo për arsye se verifikimi në terren është pjesa ma e madhe e punës që ekipi i ndreqe.com e bënë në terren. Gjithashtu, duhet kuptuar që edhe pse platforma ndreqe.com përmban databazën më të madhe të deponive, ka edhe deponi tjera që nuk janë të regjistruara ende në platformë, andaj në vazhdimësi u bëhet thirrje qytetarëve që t'i identifikojnë dhe evidentojnë ato në mënyrë që të filloj adresimi dhe procesi i largimit të tyre.

Sipas Komunave

Më secilën komunë të Kosovës është e regjistruar së paku një deponi ilegale e mbeturinave. Po ashtu, duhet të kihet parasysh se numri më i madh i deponive ilegale në një komunë nuk nënkupton se ajo komunë ka më shumë problem me mbeturina se një komunë tjetër me numër më të vogël të deponive ilegale. Për shkak se disa komuna që figurojnë me numër jo shumë të lartë të deponive, krahasimisht, në shumë raste kanë deponi që janë teje të mëdha.


Një deponi ilegale e mbeturinave që fatmirësisht është larguar nga Komuna e Deçanit nga një fshat ka qenë lehtë e dukëshme edhe nga hartat ariale të google-it (tanimë ai lokacion është plotësisht i pastruar, i gjelbëruar dhe i monitoruar). Egzistojnë edhe shumë deponi të tjera që janë po ashtu të përmasave gjigande. Ndërsa në disa komuna që rezultojnë me shumë deponi për nga numri, kryesisht në komuna që janë më urbane, një pjesë e tyre janë të përmasave më të vogla dhe në zona urbane.

Një rast i tillë është edhe me komunën më të madhe në vend (për nga numri i banorëve) pra Komunën e Prishtinës ku kanë qenë të regjistruar 307 deponi ilegale të mbeturinave prej të cilave 68 janë përditësuar si të larguara kryesisht në zona urbane. Aktualisht mbesin edhe 239 për t'u larguar kryesisht në zona rurale. Po ashtu, Komuna e Prizrenit ka të regjistruara 133 deponi ilegale ndërsa 33 janë pastruar, kështu që mbesin edhe 100 tjera. Komuna e Mitrovicës nga 80 deponi të regjistruara, në 20 nga to ka marrë masa dhe i ka pastruara dhe mbesin 60 të pa larguara apo pa përditësuara. Komuna e Gjilanit ka 98 të regjistruara por vetëm dy të larguara, përkundër që kohëve të fundit ka marrë një aksion për pastrim. Komuna e Pejës ka 33 deponi të regjistruara dhe 10 nga to i ka pastruar, pra i mbesin edhe 23 për t'u larguar nga ato të regjistruara. Komuna e Gjakovës ka 72 të regjistruara dhe 9 i ka të pastruara. Komuna e Ferizajt ka 91 deponi të regjistruara ku 12 prej tyre i ka larguar dhe mbesin edhe 79 tjera.

Komuna e Podujevës ka bërë një avancim të madh në largimin e deponive ilegale pasi nga gjithsej 36 të regjistruara, 28 janë larguar. Komuna tjera me përparim janë komuna e Deçanit e cila nga 74 deponitë e regjistruara ka larguar 20 prej tyre dhe mbesin edhe 14 për tu adresuar. Pastaj Komuna e Vushtrrisë, që nga 31 deponi të regjistruara ka larguar 12 dhe komuna e Kamenicës që nga 31 deponi të regjistruara ka larguar 19 prej tyre dhe mbesin edhe 19 që të largohen, Komuna e Vitisë ku nga 63 të regjistruara, janë larguar 27 dhe mbesin 36.



Komunat që kanë një numër të konsiderueshëm të deponive por që nuk ka patur një progres të dalluar janë: Malisheva e cila ka të regjistruar 100 deponi ilegale por vetëm katër nga to janë larguar, si dhe komuna e Drenasit që ka 103 deponi të regjistruara dhe vetëm një është konfirmuar si e larguar. Po ashtu, komuna e Shtërpcës ka 81 deponi të regjistruara dhe asnjë nuk është konfirmuar si e larguar. Komuna e Suharekës edhe pse ka bërë përpjekje vetëm shtatë nga 174 prej tyre janë përditësuar si të larguara.




Shkalla e Largimit kundrejt Raportimeve

Për arsye se problemi me deponi ilegale të mbeturinave është tejet i madh në Kosovë, masat e parandalimit janë të dobëta dhe komunat kanë shumë pak përkrahje për largimin e tyre, niveli i raportimit të deponive ilegale të mbeturinave shpesh është më i lartë se niveli i pastrimit të mbeturinave. Mirëpo kjo rezulton të jetë nëse e shikojmë në nivel të gjithë vendit. Arsyeja qëndron tek fakti se shumë komuna presin të marrin aksion për largimin e tyre pasi të akumulohen disa deponi. Në disa komuna, për disa muaj janë raportuar deponi ilegale të mbeturinave dhe nuk ka patur reagim por brenda një muaji kanë marrë aksion të largohen disa nga to. Në disa komuna ndodh që në vazhdimësi të largojnë deponi por kjo është në nivel më të ulët se ai i raportimit.

Figura 5: Numri i deponive ilegale të mbeturinave të raportuara nga qytetarë në ndreqe.com dhe numri i deponive të larguara nga komuna të ndryshme në periudhë prill-shtator, 2018



Figura 6: Numri i deponive ilegale të mbeturinave të raportuara nga qytetarët në ndreqe.com sipas komunës dhe numri i atyre të larguara



Muajt e pranverës dhe verës janë më dinamikë sa i përket largimit të deponive ilegale të mbeturinave nga komunat, gjë që është e kuptueshme. Por një gjë inkurajuese gjatë këtyre muajve të verës është fakti që niveli i raportimit të deponive ilegale nga qytetarët është po thuajse në përputhje me nivelin e largimit të deponive nga komunat. Në disa komuna më shumë janë larguar gjatë këtyre muajve sesa që janë raportuar. Nëse shohim bilancin e raportimeve të deponive me largimin e mbeturinave këtë sezon të pastrimit në nivel vendi del mjaft shpresëdhënës. Nga 1 qershori deri më 15 gusht të këtij viti janë raportuar 92 deponi ilegale në platformën ndreqe.com. Megjithatë në të njëjtën periudhë institucionet komunale kanë arritur të pastrojnë 88 deponi ilegale². Ndërsa në pesë mujorin e sezonës pranverë-verë (15 prill – 15 shtator) janë raportuar 199 deponi ilegale nga qytetarët ndërsa janë larguar 185 nga institucionet komunale. Pra vetëm 14 deponi janë raportuar më shumë se që janë larguar. Kjo tregon se në fakt, institucionet komunale me një ritëm të tillë dhe një administrim pak më të mirë të mbeturinave, pak më shumë buxhet dhe koordinim më të mirë me kompani kontraktuese do të mund ta pastrojnë Kosovën. Natyrisht, kjo arrihet vetëm nëse në të njëjtën kohë ngritet niveli i mirëmbajtjes dhe parandalimit të krijimit të deponive ilegale të mbeturinave.

Edhe më inkurajuese është fakti se disa komuna kanë arritur të largojnë më shumë deponi sesa që janë raportuar në sezonën pranverë-verë. Në Prizren gjatë periudhës 15 prill deri më 15 shtator janë raportuar 19 deponi ilegale ndërsa komuna ka arritur të largojë 29 prej tyre. Në Podujevë, gjatë kësaj periudhe janë raportuar 10 ndërsa janë larguar 22. Në Deçan janë raportuar vetëm dy deponi gjatë kësaj periudhe por komuna ka larguar 19 deponi gjatë kësaj periudhe, kjo për shkak se këto deponi të larguara kanë qenë të regjistruara më herët. Në Skenderaj, janë raportuar 14 ndërsa janë larguar 16 dhe kjo komunë në kohën e shkrimit të kësaj analize po vazhdon aksionin për largim.

Gjithashtu, në Viti, e cila po vazhdon aksionin e largimit të mbeturinave, gjatë periudhës prill-shtator ka larguar 11 deponi ndërsa janë raportuar tri. Komuna e Suharekës ka larguar 7 ndërsa janë raportuar 3 gjatë kësaj periudhe. Komuna e Rahovecit ka larguar 6 ndërsa janë raportuar 3 dhe kjo komunë është duke vazhduar aksionin. Në Komunën e Pejës është larguar një deponi më shumë sesa që janë raportuar pra 8 janë raportuar në këtë periudhë ndërsa komuna ka arritur ti largoj 9 deponi ilegale të mbeturinave. Në Shtime janë larguar 4 deponi ndërsa kanë qenë të raportuara 2 deponi gjatë kësaj periudhe. Në Han të Elezit që gjithashtu po vazhdon aksionin për largimin e deponive gjatë kësaj periudhe janë larguar 3 deponi të mëdha ndërsa është raportuar vetëm 1 deponi. Ndërsa në Junik, komunë po ashtu e vogël me territor dhe banorë nuk ka patur deponi ilegale të raportuara gjatë kësaj periudhe por komuna ka larguar 3 deponi të regjistruara më herët.

Kjo tregon se komunat do të mund të adresojnë raportimet e qytetarëve në platformën ndreqe.com dhe të zgjidhin ankesat e tyre për deponi ilegale të mbeturinave, dhe jo vetëm për këtë problem, nëse angazhohen për t'i adresuar problemet që raportojnë në lagjet e tyre dhe nëse përdorin platformën në mënyrë të mirëfilltë, duke përfshirë përgatitjen për të marrë aksion.

² Duhet pas parasysh që deponitë e larguara në atë periudhë janë jo domosdoshmërisht deponitë e raportuara në atë periudhë për shkak se komunat kanë raportime të deponive edhe më herët.


Kohëzgjatja e Reagimit të Komunës

Ajo se çfarë duhet të përmirësohet është afati kohor i reagimit të komunave në mënyrë që mos të akumulohen mbeturinat si dhe qytetarët raportues mos të humbin besimin se komuna do të adresoj raportimin e tyre. Kjo veçanërisht duhet të vlej për deponitë ilegale të mbeturinave që krijohen brenda qyteteve dhe zonave urbane ku njerëzit i kalojnë më shpesh dhe shkaktojnë problem të përditshëm të banorëve të atyre qyteteve. Por edhe reagimi është më i lehtë brenda qyteteve pasi shërbimi i mbledhjes së mbeturinave është më i gatshëm, shportat janë më të shpeshta dhe janë më lehtë të verifikueshme.

Nëse analizojmë afatin kohor të reagimit të institucioneve komunale pas raportimit shohim se nga 345 të deponive ilegale të larguara që janë të regjisturara në ndreqe.com me lokacion dhe me fotografi para largimit dhe pas largimit del se 42 deponi janë larguar brenda një jave pas raportimit. Ndërsa 20 tjera janë larguar brenda 2 jave të raportimit nga qytetarët dhe 24 janë larguar brenda 1 muaji të raportimi. Pra për 86 deponi ilegale të mbeturinave apo 25% nga 345 sa janë larguar ka pas reagim brenda një muaji, që është një periudhë e pranueshme sidomos për deponi që janë akomoluar me vite dhe kanë arritur përmasa të mëdha. Duhet theksuar se në disa raste ka marrë kohë edhe përditësimi i gjendjes në platformë si dhe fotografimi i lokacionit ku deponia është larguar pasi secili raportim që përditësohet duhet të ketë edhe fotografinë pas intervenimit.

Ndërsa për 24 deponi tjera është dashtur 2 muaj deri tek largimi nga komuna. Për shumicën e deponive të mbeturinave që janë larguar ka marrë kohë 2 muaj deri në 6 muaj (125 deponi). Ndërsa për një pjesë tjetër të konsiderueshme, 110 deponi ilegale, ka marrë kohë 6 muaj deri në 1 vit për tu larguar. Megjithatë, deponitë ilegale që janë larguar brenda 6 muaj deri në 1 vit, kjo kohë e gjatë është më shumë për shkak të kohë që ka marrë që zyrtarët komunal të njoftohen mirë me platformën ndreqe.com si dhe përdorimin e administrimit e saj.

Figura 7: Sa kohë kanë marrë komunat për largimin e deponive dhe përditësimin e gjendjes në ndreqe.com



- Periudha e largimit pas raportimit

Kohëzgjatja	Pastruar
7 ditë	42
14 ditë	20
1 muaj	24
2 muaj	24
6 muaj	125
1 vit	110
Gjithsej 345	



IV. Sfidat e largimit të deponive ilegale

Për të kuptuar më mirë problemin me largimin e deponive ilegale të mbeturinave dhe mos përsëritjes së deponive ilegale, ekipi i ndreqe.com ka intervistuar 18 zyrtarë për menaxhimin e mbeturinave të cilët e njohin më së miri këtë problematikë. Sfidat e problemit të komunave dhe Kosovës me deponi ilegale të mbeturinave mund të ndahen kryesisht në dy kategori: 1) ato të menaxhimit dhe administrimit ku përfshihet edhe mirëmbajtja pas largimit të deponive si dhe 2) ato të kontraktimit dhe koordinimit me kompani për largimin e deponive. Në pjesën më poshtë mund të shihen disa nga sfidat që paraqiten për disa apo shumicën e komunave dhe janë në përgjithësi sfidë për institucionet e Kosovës.



Menaxhimi dhe Administrimi

Mungesa e Inspektorëve dhe Gjobave

Përpos akumulimit të mbeturinave në deponi ilegale në vitet e fundit, sfidë mbetet parandalimi i krijimit të deponive të reja dhe rikrijimi i atyre që janë larguar njëherë. Dhe kjo është pjesë kyçe e menaxhimit dhe administrimit të mbeturinave në komunë. Masat parandaluese apo mungesa e tyre mbetet problem i pazgjidhur në pothuajse të gjitha komunat e Kosovës. Madje kjo gjendje dekurajon shumë institucione komunale që të pastrojnë dhe mirëmbajnë pastërtinë e hapësirave ku akumulohen deponitë ilegale të mbeturinave. Parandalimin e krijimit të deponive ilegale mund ta bëjnë vetëm veprimet e inspektorëve dhe një sistem i gjobave funksional dhe me ndëshkime të konsiderueshme. Ministria e Mjedisit, në tetor të 2018, aprovoj Udhëzimin Administrativ për Gjobat Mandatore që përcakton gjobat mandatore për ndotësit e ambientit duke filluar nga hedhja e një letre nga një individ e deri tek hedhja e mbeturinave më të ndërlikuara në sasi të mëdha³. Kjo obligon inspektorët e kësaj ministrie, inspektorët komunal dhe policinë e Kosovës që të vëjë këto gjoba dhe të ndjek personat dhe kompanitë që hedhin mbeturina.

Mirëpo, për të zbatuar këtë udhëzim administrativ duhet të ketë inspektorë të mjaftueshëm dhe përkrahje institucionale për ta. Në nivel komunal mungesa e inspektorëve është tejet e evidente. Më tutje, inspektorët nuk paguhen për punën jashtë orarit që kryejnë në terren edhe pse ndotësit e ambientit nuk kanë orare⁴. Në disa komuna që janë mjaft efektive në largimin e deponive ilegale dhe sfidë e vetme për to mbetet parandalimi dhe gjobitja e keqpërdoruesve të hapësirave publike. Disa komuna si ajo e Lipjanit që e kanë një territor tejet të shpërndarë ndërsa janë kryesisht rurale, ndërsa kanë vetëm dy inspektorë komunal⁵. Megjithatë, institucionet komunale nuk kanë investuar në inspektorë dhe inspektime për të përmirësuar problemin e madh që kanë me deponi ilegale të mbeturinave. Kjo vjen edhe si rezultat i kufizimeve në administratë që kanë por edhe për shkak të prioriteteve tjera në komunë.

³ Udhëzim Administrativ Nr. 06/2018 Për Ndëshkimet me Gjoba Mandatore. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor. <https://goo.gl/epKMwa>

⁴ Intervistë me Zyrtarin për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës, Rizah Muçolli. 20 tetor, 2018.

⁵ Intervistë me Zyrtarin për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Lipjanit, Labinot Dedushi. 22 tetor, 2018.

Mbulueshmëria Jo e Plotë me Shërbim

Ofrimi i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, kontejnerët për çdo lagje e fshat si dhe mbledhja e rregullt e mbeturinave, janë hallkë kyçe e mirëmbajtjes së ambientit të pastër. Mungesa e mbulueshmërisë së tërë komunës me shërbim për mbledhjen e mbeturinave është një sfidë që po i përcjell shumicën e komunave në Kosovë. Në nivel vendi mbulueshmëria e shërbimit të mbledhjes së mbeturinave është 57,7%⁶. Edhe pse mbulueshmëria e shërbimit për mbledhje të mbeturinave është duke u zgjeruar në vazhdimësi nga shumë komuna, vetëm gjashtë komuna kanë mbulueshmëri të plotë të komunës me pika mbledhëse të mbeturinave dhe shërbim të mbledhjes së mbeturinave⁷. Problemi më i madh me mbulueshmëri mbeten zonat rurale ku dhe akumulohen më së shumti deponitë ilegale të mbeturinave. Në nivel vendi, mbulueshmëria me shërbimit është në shkallën 41% ndërsa në zona urbane 75%, sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2016.




Figura 8: Shkalla e mbulueshmërisë së territorit të komunës me shërbim për mbledhjen e mbeturinave

Mos ofrimi i shërbimit për mbledhje të mbeturinave i shtyn edhe shumë amvisëri të hedhin mbeturinat në vende publike që është jo-ligjore. Përderisa nuk ju ofrohet shërbimi amvisërive nuk ju lihet ndonjë zgjidhje tjetër. Komunitat ankohen shpesh në qytetarë që nuk paguajnë shërbimin apo nuk kanë interes të marrin shërbime për shkak se duhet të fillojnë të paguajnë për atë shërbim. Në fakt, të dhënat e Ministrisë tregojnë se shkalla e arkëtimit të faturave aty ku shtrihet shërbimi është 77,9%.

Megjithatë, pa u ofruar shërbimi në gjithë territorin e komunës në mënyrë që banorët të kenë opsionin e hedhjes së mbeturinave në vende të caktuara, sfida për deponi ilegale që krijohen nga mbeturinat e amvisërive do të vazhdojë. Këtu qëndron edhe mungesa e informimit të popullatës se ku mund dhe se ku duhet të hedhen mbeturinat të vëllimshme si orendi të vjetra shtëpiake apo pajisje të vjetra. Këto lloj mbeturina nuk mund të hedhen në kontejner edhe ky shërbim duhet të ofrohet. Komuna e Prizrenit ofron dy herë në vit një shërbim ku shkon në lagje gjatë një jave dhe mbledh mbeturina të vëllimshme të amvisërive, një iniciativë kjo mjaft e mirë, përpos

⁶ Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. (maj, 2018)

⁷ Prizren, Hani i Elezit, Novobërdë dhe Shtërpce.



që mbulueshmëria e kësaj komunë me shërbim është 100%. Ngajshëm vepron nganjëherë edhe Komuna e Prishtinës. Megjithatë, ky shërbim duhet të zgjerohet në komuna tjera si dhe të kemi fushata informuese se ku mund të hedhen këto lloj mbeturinash.

Resurset Administrative për Menaxhim

Resurset administrative për menaxhimin e mbeturinave janë një sfidë tjetër që paraqitet në komuna të Kosovës pasi ky është një operacion i madh, i komplikuar dhe që kërkon vëmendje të vazhdueshme. Përpos ofrimit të shërbimit dhe mbledhjes së mbeturinave, largimi i deponive ilegale që janë akumuluar me vite të tëra dhe parandalimi i deponive të reja janë detyra që kërkojnë resurse administrative në komunë. Një zhvillim i mirë në vitet e fundit është që në secilën komunë tashmë është i caktuar një zyrtarë për menaxhimin e mbeturinave në drejtori për shërbime publike. Kjo e vë një vëmendje më të madhe në menaxhimin e mbeturinave. Megjithatë, menaxhimi i mbeturinave kërkon planifikim për menaxhim të mbeturinave, koordinim me zyrtarë tjerë komunal si dhe koordinim me kompani kontraktuese në mënyrë që cikli i menaxhimit të mbeturinave të funksionojë si duhet.

Siç shihet, me numrin e madh të deponive ilegale të mbeturinave, mbulueshmërinë jo të plotë me shërbim si dhe vetëdijesimi kryesisht i ulët të qytetarëve për mirëmbajtje të ambientit, vetëm një apo dy persona është vështirë të menaxhojnë mirë këtë detyrë. Zyrtarë komunal të cilët janë konsultuar për këtë analizë tregojnë sfida të mëdha që paraqiten në punën e tyre për menaxhim sa më të mirë të mbeturinave në territorin e komunës së tyre. Menaxhimi i mbeturinave në gjitha komunat është nën një drejtori komunale që ka edhe përgjegjësi tjera, si drejtori e shërbimeve publike, dhe këto drejtori janë të ngarkuara edhe me shumë obligime tjera. Kjo shkakton shpesh humbje të vëmendjes nga menaxhimi i mbeturinave.

Kontraktimi për Largimin e Deponive

Kapacitetet e Ndërmarrjeve Publike

Për të larguar deponitë ilegale shumë komuna varen nga ndërmarrja publike. Mirëpo kapacitetet e shumë nga këto ndërmarrje publike janë të pamjaftueshme për t'i larguar deponitë ilegale në komuna që janë akumuluar. Në shumë komuna si Peja, Ferizaj, Gjakova zyrtarët për menaxhimin e mbeturinave deklarohen që ndërmarrja publike ka nevojë për të shtuar kapacitetet e saj për të larguar deponitë e mbeturinave⁸. Në Ferizaj, zyrtari për menaxhimin e mbeturinave deklarohet se edhe pse janë të kënaqur deri diku me punën e ndërmarrjes publike (KRM Pastërtia) kjo kompani ka mungesë të theksuar të mekanizmave për heqjen e deponive⁹.

Në Pejë, vërehet që ka nevojë që në Ndërmarrjen Publike (KRM Ambienti) të shtohen kapacitetet pasi që janë tejet të ulëta. Në komunën e Vushtrrisë dhe Mitrovicës po ashtu, ku ndërmarrja Uniteti edhe pse ndërhyr për largim të deponive pas kërkesës së zyrtarëve komunal, kapacitetet janë të mangëta dhe nuk mund të mbërrij në shumë prej tyre. Po ashtu edhe në Gjakovë shihet nevoja për të kontraktuar kompani private pasi ndërmarrja publike Çabratit nuk ka kapacitete e nevojshme. Në Podujevë dhe Prishtinë, ndërmarrja publike "Pastrimi" kryesisht ndërhyr vetëm për mbeturina më të vogla brenda zonave urbane për mungesë të kapaciteteve. E njëjta ndërmarrje në Lipjan largon vetëm deri në 1000m³ në vit pasi ajo është marrëveshja me komunën dhe kur të tejkalohet kjo sasi, mbeturinat nuk largohen.

8 Intervistë me Zyrtarët për Menaxhimin e Mbeturinave të këtyre komunave. 17-25 tetor, 2018.

9 Intervistë me Zyrtarin për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Ferizajt, - Ismajl Mehmeti. 23 tetor, 2018.

Kontratrat me Kompani Private

Komunat që kanë pas më shumë efekt në largimin e deponive ilegale të mbeturinave kanë angazhuar kompani private për largimin e tyre. Në Viti, një komunë e cila ka qenë mjaft e përqendruar për të larguar deponitë ilegale, kanë angazhuar një kompani publiko-private por edhe atje vërehet se nuk janë kapacitetet e majftueshme. Njëjtë në Deçan, një komunë që ka qenë mjaft e vëmendshme në largimin e deponive, ndërmarrja private e kontraktuar ka mungesë të kapaciteteve por edhe sfida në menaxhimit. Në Podujevë, komunë tjetër që janë larguar një pjesë e madhe e deponive ilegale të regjistruara, janë angazhuar tri ndërmarrje private për të kryer këtë punë si shkak i mungesës së kapaciteteve.

Ndërsa në Han të Elezit ndër sfidat më të mëdha mbetet mungesa e një kompanie për të bërë administrimin dhe largimin e deponive ilegale. Këto kufizime të ndërmarrjeve publike por edhe atyre private të kontraktuara paraqesin sfida shumë të madhe për të adresuar problemin e deponive ilegale të mbeturinave. Kur shtojmë këtu se edhe shumë komuna më të vogla, si Han të Elezit dhe Dragashi¹⁰, nuk kanë vende të caktuar për të transportuar deponitë e mbledhura, ky proces bëhet pothuajse i pa menaxhueshëm.

Mungesa e Buxhetit

Mungesa e mjeteve financiare për largimin e deponive ilegale të mbeturinave dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike është përmendur nga të gjithë 18 zyrtarët komunal të intervistuar. Pothuajse të gjithë zyrtarët për menaxhimin e mbeturinave thonë se po të kishim më shumë mjete financiare për të kontraktuar kompani, gjendja do të përmirësohej. Duhet pasur parasysh që deponitë ilegale të mbeturinave janë akumuluar me vite dhe dekada në disa vende dhe fondet që nevojiten janë të shumta. Prandaj edhe pse disa komuna ndajnë buxhet për largim të mbeturinave nuk është se mjaftojnë për të larguar pjesën më të madhe.

Nëse shohim buxhetet e komunave për vitin 2018, vetëm 10 prej tyre kanë ndarë ndonjë buxhet të veçantë për largimin e deponive ilegale të mbeturinave. Dhe buxheti i përgjithshëm i këtyre 10 komunave për këtë kategori del të jetë pak mbi 800,000 Euro, edhe pse në disa komuna vija buxhetore për largimin e mbeturinave përfshinë edhe shërbime të tjera si intervenimi pas fatkeqësive natyrore (Prizren) apo rrënimi i objekteve (Kaçanik). Ndërsa vetëm shtatë komuna kanë ndarë buxhet të veçantë për mirëmbajtje dhe zgjerim të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Buxheti i përgjithshëm i këtyre komunave për këto shërbime shkon në 660,000 Euro¹¹.

Kjo tregon qartë se përpos disa komunave si Prizreni, Prishtina, Ferizaj dhe Mitrovica komunat tjera ose nuk mund të gjejnë buxhet për largimin e deponive ilegale dhe zgjerimin e buxhetit ose nuk i japin prioritet kësaj punë për arsye të ndryshme. Sido që të jetë, buxheti paraqet sfida për largimin e deponive ilegale të identifikuar në ndreqe.com. Zyrtari komunal nga Dragashi tregon se edhe pse janë të vetëdijshëm për raportimet në ndreqe.com dhe kanë interesin t'i largojnë ato, buxheti nuk mjafton për të punuar në atë drejtim. Madje edhe zyrtarët nga komunat si Prishtina dhe Ferizaj, të cilat kanë ndarë buxhet të veçantë për largimin e mbeturinave, thonë se buxheti paraqet problem për deponitë ilegale në fshatra të cilat janë akumuluar me vite dhe masa e tyre është shumë më e madhe, rrjedhimisht edhe janë shumë më të kushtueshme¹².

10 Intervistë me Zyrtarin për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Han Elezit (23 tetor, 2018) dhe Zyrtarin për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Dragashit (23 tetor, 2018).

11 Ligji Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018. Ministria e Financave <https://goo.gl/6ncMWL>

12 Intervistë me Zyrtaren për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Prishtinës (20 tetor, 2018) dhe Zyrtarin për Menaxhimin e Mbeturinave të Komunës së Ferizajt (23 tetor, 2018).



Figura 9: Komunitat që kanë ndarë një buxhet të veçantë në 2018 dhe 2019 për largim të deponive ilegale

BUXHETI KOMUNAL PËR LARGIMIN E DEPONIVE ILEGALE		
2018		
KOMUNA	VIJA BUXHETORE	BUXHETI
Prizren	Intervenimi në infrastrukturë për rastet me fatkeqësi natyrore (rrëshqitja e dheut, përmbytjet etj) dhe eliminimi i deponive ilegale	€ 300,000
Prishtinë	Trajtimi i mbeturinave ndërtimore	€ 150,000
Mitrovicë	Largimi i deponive të egra	€ 100,000
Ferizaj	Rregullimi, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbruara dhe heqja e mbeturinave	€ 98,000
Fushë Kosovë	Mirëmbajtja e hapsir. pub., përkufizime, pastrim, inertet.	€ 90,000
Suharekë	Eliminimi i deponive ilegale	€ 30,000
Rahovec	Menaxhimi dhe mirëmbajtja e mbeturinave të ngurta	€ 20,000
Istog	Eliminimi i mbeturinave nga hapsirat publike	€ 20,000
Glogovc	Rregullimi i deponive mbeturinave inerte	€ 15,000
Kaçanik	Rrenimi i obj. dhe largimi i deponimeve ilegale	€ 10,000
TOTAL		€ 833,000
2019		
KOMUNA	VIJA BUXHETORE	BUXHETI
Prishtinë	Trajtimi i mbeturinave ndërtimore	€ 150,000
Ferizaj	Rregullimi, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbruara dhe heqja e mbeturinave	€ 100,000
Suharekë	Trajtimi i deponive ilegale	€ 85,000
Mitrovicë	Eliminimi i deponive të egra	€ 80,000
Fushë Kosovë	Mirëmbajtja e hapësirave publike, përkufizime, pastrim, inerte etj	€ 40,000
Mamushë	Riparimi i parqeve dhe shportave metalike për mbeturina-Mamushe	€ 30,000
Deçan	Deponitë Inerte Ilegale	€ 30,000
Lipjan	Eliminimi i deponive të mbeturinave dhe rregullimi i hapësirave	€ 25,000
Kaçanik	Rrenimi i obj. dhe largimi i deponimeve ilegale	€ 25,000
Istog	Eliminimi i mbeturinave nga hapsirat publike	€ 10,000
H.Elezit	Rregullimi i deponive për hudhje të materialeve të ngurta	€ 10,000
TOTAL		€ 585,000

Figura 10: Komunat që kanë ndarë një buxhet të veçantë në 2018 dhe 2019 për shtrirjen e shërbimit për menaxhim të mbeturinave

PËRMIRËSIMI I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE		
2018		
KOMUNA	VIJA BUXHETORE	BUXHETI
Fushë Kosovë	Mirëmbajtja, pastrimi i ambientit, pusetave, ngritja e për	€ 220,000
Prishtinë	Rregullimi i vendeve të kontejnerëve dhe furnizimi me k	€ 150,000
Prishtinë	Furnizimi me makineri , paisje dhe kamion per bartjen e	€ 150,000
Prishtinë	Shportat e mbeturinave të xhepit dhe ulëseve të parqeve	€ 50,000
Deçan	Kontinjerë për mbeturina, Participim.	€ 20,000
Istog	Blerja e kontejnerëve për mbeturina	€ 20,000
Istog	Ndertimi i deponisë në Tuçep	€ 20,000
Vushtrri	Blerja e kontejnerëve për mbeturina	€ 20,000
Obiliq	Furnizimi me kontenjere	€ 10,000
Glllogovc	Blerja e Kontinjerve dhe shportave per mbeturina	€ 5,000
TOTAL		€ 660,000
2019		
KOMUNA	VIJA BUXHETORE	BUXHETI
Suharekë	Mirëmbajtja dhe pastrimi i qytetit	€ 145,000
Fushë Kosovë	Blerja e Kontinjerve dhe Komposterve	€ 100,000
Deçan	Makina dhe kamionë për pastrimin e mbeturinave	€ 45,000
Prishtinë	Shportat e mbeturinave te xhepit	€ 40,000
Ferizaj	Ndertimi i ulëseve, toaleteve publike, shportave per mb	€ 30,000
Istog	Ndërtimi i deponisë në Tuçep	€ 15,000
Vushtrri	Blerja e kontejnerëve për mbeturina	€ 15,000
Ferizaj	Kontenjere nentokesor	€ 15,000
Drenas	Mirëmbajtja dhe renovimi i pikave per kontinjer 1.1m ³ ne d	€ 15,000
Obiliq	Furnizimi me kontenjere	€ 10,000
Junik	Furnizimi me kontejner për mbeturina	€ 5,000
TOTAL		€ 435,000

Lokacionet e Caktuara për Transportim

Një sfidë që po bëhet çdo vit e më e madhe është edhe lokacioni për të transportuar deponitë e larguara. Deponitë legale për mbeturina janë të stërmbushuara ndërsa komunave më të vogla po u paraqiten problem ku të transportojnë deponitë kur t'i largojnë. Zyrtari për menaxhim të mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit tregon se “sfida më e madhe për largimin e deponive ilegale ekzistuese për komunën tonë është vendi për deponimin e më-tutjeshem të tyre, pasi që mungon nje vend i caktuar ku komuna mund të mbledh deponitë e tilla që mund të jetë i miratuar nga kuvendi i komunës.” Njëjtë del të jetë edhe në komunën e Dragashit, një komunë që e ka mjaft larg deponinë legale në Prizren.




V. Organizimi për Intervenim të Shpejt mbi Raportimet

Përpos që ka shumë sfida siç u përmenden më lartë, kjo analizë përqendrohet në dy pjesë të cilat platforma ndreqe.com mund të ndihmojë në përmirësimin e performancës: 1) organizimin e administratës për të reaguar më shpejt dhe më mirë pas raportimeve të deponive ilegale dhe 2) përpilimi i kontratave bazuar në evidenca të ndreqe.com që siguron më shumë efektivitet.

Në të shumtën e rasteve, udhëheqës komunal bëjnë përpjekje për të adresuar këto raportime të qytetarëve me qëllim që t'iu përmirësojnë jetën qytetarëve. Megjithatë, këto përpjekje ndodh të ndeshen me burokraci administrative që e vështirëson ndërhyrjen e shpejtë për të rregulluar këto probleme në lagje dhe fshatra ku raportohen. Në disa raste, edhe pse urdhëri për veprim ipet, ankesat qytetare nuk merren me prioritet të lartë nga zyrtarë administrativ komunal dhe ndërhyrja për veprim merr një kohë të gjatë.

Gjithashtu, ngecje për reagim të shpejt në ankesa të qytetarëve janë edhe rastet kur ka paqartësi në administratë se përgjegjësi e kujt është ajo punë. Me komunitat me të cilat ekipi i ndreqe.com ka bashkëpunim përmes memorandumit të bashkëpunimit, paraprakisht është diskutuar organizimi i një personi apo ekipi përgjegjës për shqyrtimin dhe procedimin e mëtutjeshëm të raportimeve të qytetarëve në ndreqe.com. Megjithatë, procedimi në faza të mëtutjeshme nganjëherë çalon në disa hallka apo jo të gjitha hallkat përcillen në mënyrë që të ketë efektin më të madh për njoftim të raportuesit dhe dhe informim të qytetarëve (një qëllim tjetër ky për të cilin platforma mund të përdoret nga institucionet komunale).

Platforma ndreqe.com më së miri shfrytëzohet nëse ndërmerren disa hapa të thjeshtë por të rëndësishëm për intervenim pas një raportimi dhe për komunikim me raportuesin dhe publikun për intervenimin e bërë. Platforma mundëson që zyrtarët komunal të administrojnë, përditësojnë dhe komunikojnë secilin raportim përmes qasjeve që kanë për komunën e vet.



Ajo çfarë do të shpejtonte intervenimin e administratës në adresimin e një raportimi qytetar në platformën ndreqe.com është nëse do të diheshin qartë përgjegjësitë dhe koordinimi do të ishte i mirë. Më e rëndësishmja është që të jetë një person brenda administratës që e udhëheq këtë proces pra nga raportimi e deri tek adresimi dhe komunikimi i intervenimit. Në rastin e raportimit të një deponie ilegale të mbeturinave ai person me siguri se duhet të jetë zyrtari për menaxhimin e mbeturinave ndërsa për raportime tjera si gropë në rrugë, ndriçim publik apo çkado një zyrtarë nga drejtoria përgjegjëse për atë raportim. Ky zyrtar do duhej dhe ta ketë qasjen në administrimin e platformës ndreqe.com për komunën përgjegjëse.

Hapi i parë pas raportimit të një ankese do duhej vegëza elektronike e raportimit (linku) t'i përcillej inspektorit komunal i cili do duhej të verifikon lokacionin ku është raportuar dhe që gjendja e deponisë ilegale reflektohet në fotografitë që janë raportuar për atë lokacion. Pas verifikimit, hapi i dytë do të duhej të ishte delegimi i raportimit tek kompanitë kontraktuese për adresimin e problemit, në këtë rast kompania për largimin e deponive ilegale. Ndërsa, në momentin e delegimit tek kompania, zyrtari menaxhues do duhej të përditësoj gjendjen e raportimit si të 'deleguar' përmes një komenti në raportim dhe ndryshimit të gjendjes në platformë (opsion që e mundëson platforma). Kjo do të shërbente për dy arsye: 1) të informoj raportuesin se administrata komunale ka marrë veprim për të adresuar problemin e raportuar dhe 2) të mbaj evidencë për komunën se cilat raportime janë shqyrtuar dhe deleguar tek kompania kontraktuese dhe cilat ende presin të delegohen. Hapi i radhës pas delegimit, do të ishte në fakt adresimi i problemit nga kompani kontraktuese, në këtë rast largimi i deponisë nga kompania për menaxhimin e mbeturinave dhe fotografimi pas largimit. Kurse pas largimit të deponisë, zyrtari për menaxhimin e mbeturinave do duhej të përditësoje prapë gjendjen e raportimit, kësaj radhe si të 'rregulluar' me çka do të informohej raportuesi dhe platforma do ta hiqte raportimin nga kategoria 'raportuar' dhe do ta zhvendoste në 'të rregulluar'.

Koha e intervenimit të institucioneve komunale pas raportimit për deponi ilegale të mbeturinave shpesh zgjatet për shkak se koordinimi brenda administratës çalon për arsye burokratike apo për shkak të mos organizimit të duhur të administratës për të intervenuar në raportime të qytetarëve.

Udhëheqësit komunal duhet të rregullojnë procesimin e ankesave qytetare nga administrata e tyre si dhe procesin e rregullimit të tyre nga kompani kontraktuese. Njëkohësisht, komunikimi me qytetarë të përgjegjshëm që marrin kohën dhe mundin të raportojnë këto ankesa për të mirën e komunitetit, do duhej të rregullohej.

Për këto arsye, kryetari i komunës dhe drejtori i administratës duhet të riorganizojnë administratën për të procesuar sa më shpejt ankesat qytetare për mirëmbajtje të hapësirave publike dhe infrastrukturës. Nisje e mirë për këtë veprim është fillimi me një plan që specifikon kush është përgjegjës për pranimin e ankesave qytetare për hapësira publike, kush është përgjegjës për rregullimin e secilës lloj ankese, si duhet vepruar për të rregulluar këto raportime dhe si duhet komunikuar me qytetarët e përgjegjshëm që marrin kohë të raportojnë këto ankesa.

Njëkohësisht, udhëheqësit komunal duhet të nisin një bashkëpunim me platforma të ndryshme që u mundësojnë qytetarëve të evidentojnë dhe raportojnë ankesat për lokalitetet e tyre. Këto platforma mund të jenë mënyra të mira për të ndihmuar administratën në adresim të këtyre ankesave por edhe për të provuar punën e komunës kur vepron dhe reagon shpejt për adresimin e ankesave të qytetarëve.

VI. Përpilimi i kontratave me kushte për intervenim të shpejt


Sigurisht që rregullimi i shumë pengesave në hapësira publike varet nga ndërmarrjet publike komunale apo ndërkomunale apo nga kompanitë të kontraktuara nga komuna. Zakonisht për pastrimin e mbeturinave të raportuar në zona urbane dhe aty ku ka shërbim, përgjegjëse është ndërmarrja komunale e pastrimit, ndërsa për deponi ilegale të akumuluar me vite, kryesisht në zona rurale, përgjegjëse mund të jetë kompania private që është kontraktuar nga komuna për këto punë. Megjithatë, nëse një qytetar i përgjegjshëm raporton një ankesë të tillë në komunitetin e vetë, pritja e tij është se komuna është përgjegjëse. Andaj, institucionet komunale do duhej të kishin një linjë komunikimi me këto ndërmarrje publike apo kompani kontraktuese që nga momenti kur një ankesë e tillë raportohet, ajo të përcillet menjëherë dhe pastaj komuna të merr informatën e gjendjes së ankesës.

Edhe në këtë rast mund të ndodh që kompania mos të merr me prioritet raportimin nga qytetarët dhe të mos të ndërhyjë në kohë të shpejt. Për këtë arsye, udhëheqësit institucional gjatë procesit të kontraktimit dhe marrëveshjeve me këto ndërmarrje do duhej të obligojnë palën tjetër që ndërhyrjet të bëhen edhe pas kërkesave të qytetarëve dhe që këto kërkesa të merren me prioritet.

Platforma ndreqe.com ndihmon në tri aspekte të procesit të kontraktimit të kompanisë private për largimin e deponive dhe mirëmbajtjen e atyre hapësirave. Së pari platforma mund të shfrytëzohet për të përgatitur kriteret dhe kërkesat për prokurim publik të kompanisë private. Pra në platformë ndreqe.com mund të gjenden deponitë ilegale të mbeturinave me lokacione të sakta dhe me fotografi që tregojnë gjendjen, më saktësisht llojin e mbeturinave dhe sasinë e mbeturinave në ato lokacione. Shih Aneks IV për një shembull të mirë të kushteve të kontratës për kompani private për largimin e deponive në Komunën e Podujevës që është e bazuar në raportime të evidencuara. Aty precizohen lokacionet e sakta të deponive që kërkohet kontraktim për t'i larguar si dhe përcaktohet sasia përmes metrave kubë, pra dy informata që mund të merren nga ndreqe.com. Po ashtu, në Aneks V është një shembull jo i mirë i kushteve të kontratës për largim të deponive pasi nuk precizohet lokacioni i saktë ndërsa kontraktimi i largimit të deponive bëhet me orë pune dhe jo me sasi për metër kubë.

Figura 12: Në cilat faza mund të shërbej ndreqe.com për kontratat për largim të deponive ilegale.

Kontraktimi bazuar në evidencë në ndreqe.com



Së dyti, përcaktimi i kostos së ofertës për kontratë mund të bëhet duke u bazuar në evidencën e deponive të regjistruara në ndreqe.com. Këto raportime do ta ndihmonin edhe kompanitë tenderuese që të përcaktojnë çmimin por edhe kompaninë fituese që të planifikojmë më lehtë zbatimin e kontratës. Së treti, përpilimi i kontratës në bazë të raportimeve në ndreqe.com dhe kërkesa në ofertë që kompania implementuese të bëjë fotografitë pas ndërhyrjeve do të ndihmojë zyrtarët komunalë që të mbikëqyrin më lehtë kontratën e bërë me kompaninë fituese. Ndreqe.com përpos që tregon evidencën si dhe ku është raportuar një deponi ilegale, e lejon edhe përditësimin e një raportimi nga zyrtarët komunalë që ata të ngarkojnë fotografitë pas intervenimit dhe të përditësojnë si të mbyllur atë raportim.

Megjithatë, për të qenë më efektiv në largimin e deponive ilegale të mbeturinave, kontrata me kompani kontraktuese duhet të përpilohen me kusht që kompania të jetë e obliguar që të ndërhyjë për largimin e deponisë momentin që raportohet nga një qytetar dhe verifikohet nga inspektorët. Ky lloj kontraktimi kërkon një fleksibilitet në kushte të kontraktues pasi nuk përcaktohen vetëm deponitë që janë evidencuar në të kaluarën por edhe deponitë që mund të krijohen apo raportohen në të periudhën e kontratës. Aktualisht, kompanitë zakonisht presin të akumulohen disa deponi ilegale para se të bëjnë një tender për të larguar deponitë ilegale dhe pas kontraktimit, kompania kontraktuese shkon dhe i largon vetëm ato që janë përcaktuar me kontratë dhe të tjerat që mund të paraqiten apo evidencohen në ndërkohë.

Ky lloj i kontraktimit i bazuar në kërkesa të vazhdueshme do ta përmirëson dukshëm gjendjen e pastërtisë të mirëmbajtjes në komunë. Njëkohësisht do t'a përmirësonte dukshëm kohën e intervenimit të komunës pas raportimit dhe evidencimit të një deponie ilegale. Me përmirësimin e intervenimit do të rritej edhe besimi i qytetarëve në shërbimet komunale të komunës si dhe do të përmirësohej monitorimi i lokacioneve me rrezik për shëndërrim në deponi ilegale.

VII. Rekomandimet

Ekipe të Reagimit të Shpejt për Raportime të Qytetarëve

Kryetari i Komunës duhet të punoj me udhëheqësit e dikasterit të administratës, shërbimeve publike dhe inspektoratit që të ndërtojnë ekipe të reagimit të shpejt për raportime të ankesave qytetare për shërbime publike. Ekipet e reagimit të shpejt duhet të jenë për kategori të ndryshme të shërbimeve publike (mbeturina, gropa në rrugë, ndriçim, ujëra të zeza etj) dhe duhet të trajnohen për të ndjekur Hapat e Adresimit të Raportimit (shih grafikën në faqen 21).

Platforma për raportime të ankesave vetëm është e gatshme përmes ndreqe.com e cila përpos mundësisë për regjistrim të raportimeve të qytetarëve, mundëson edhe administrimin e atyre raportimeve nga zyrtarët komunal. Një zyrtar komunal duhet të caktohet si administratorë i platformës për çdo kategori të raportimit p.sh. për mbeturina të caktohet zyrtari për menaxhimin e mbeturinave, për gropa në rrugë të caktohet zyrtari brenda drejtorisë së shërbimeve publike që ka këtë përgjegjësi, e kështu me radhë.

Përpilimi i Kontratave me Kushte për Intevenim të Shpejt

Kontratat e komunave për shërbime publike si largimin e deponive ilegale, kontrata për mirëmbajtje të rrugëve (ku përfshihen sanimi i gropave) dhe kontrata për ndriçim publik duhet të përfshijnë një kusht që kompania kontraktuese do të ndërtoj brenda një afati të caktuar pas urdhërësës së zyrtarit mbikëqyrës të kontratës. Kjo do të mundësonte intervenimin e shpejt për adresimin e problemit të raportuar nga qytetarët në ndreqe.com.

Për shkak se intervenimi në adresimin e një problemi të raportuar shpesh ngec tek kompania kontraktuese atëherë një kusht duhet të futet në kontratë që e obligon kompaninë kontraktuese të ndërtojë për kërkesa ditore të qytetarëve. Kështu kontratat e komunave për shërbime publike do të bëheshin më shumë për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve aktiv dhe jo vetëm kërkesave të zyrtarëve komunal.

Përpilimi i Kontratave duke u Bazuar në Evidenca të Raportimeve në ndreqe.com


Hartimi i kontratave për shërbime të ndryshme që kërkohen nga qytetarët, mbeturina, gropa etj, duhet të përpilohen duke saktësuar shërbimet që kërkohen dhe duke caktuar një shumë për kontratë që bazohet në të dhëna që tregojnë nevojat e sakta për këto shërbime. Platforma ndreqe.com është burim për të hartuar kontratën pasi në rastin e kontraktimit të kompanisë për largimin e deponive ilegale, mund të saktësohen lokacionet me deponi ilegale të mbeturinave (madje edhe me koordinata gjeografike). Njëkohësisht, fotografitë e deponive ilegale të mbeturinave të raportuara tregojnë sasinë e mbeturinave që mund të përcaktoj koston për largimin e mbeturinave. Një shembull i mirë është kontrata për largim të deponive ilegale për vitin 2018 nga Komuna e Podujevës (shih Aneks IV).

Planifikimi i Buxhetit të Veçant për Largimin e Deponive

Largimi i deponive ilegale të mbeturinave të akumuluar ndër vite nuk përfshihet në marrëveshje të komunës me ndërmarrje publike që ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave. Kjo pasi largimi i deponive ka kosto shtesë të largimit dhe transportimit në deponi legale. Andaj, komunat duhet të ndajnë buxhet të veçantë për largimin e deponive ndërsa ky buxhet duhet të përcaktohet duke u bazuar në evidencat në ndreqe.com.

VIII. Anekset

Aneks I: Numri i Deponive të Larguara sipas Muajit




Aneks II: Shkalla e Largimit të Deponive sipas Komunave

PERFORMANCA KOMUNALE

LARGIMI I MBETURINAVE TË RAPORTUARA

20 NËNTOR, 2018

	■ RAPORTUAR	■ NDREJOUR	
1. PODUJEVË	36	28	✓ 77.8%
2. KAMENICË	31	19	✓ 61.3%
3. DECAN	34	20	✓ 58.8%
4. VITI	63	27	✓ 42.9%
5. SKENDERAJ	61	26	✓ 42.6%
6. HANI I ELEZIT	22	7	✓ 31.8%
7. PEJË	33	10	✓ 30.3%
8. VUSHTRRI	40	12	✓ 30.0%
9. RAHOVEC	57	17	✓ 29.8%
10. MITROVICË	80	21	✓ 26.3%
11. PRIZREN	133	33	✓ 24.8%
12. OBILIQ	13	3	✓ 23.1%
13. PRISHTINË	307	68	✓ 22.1%
14. SHITIME	25	4	✓ 16.0%
15. F. KOSOVË	30	4	✓ 13.3%
16. FERIZAJ	91	12	✓ 13.2%
17. JUNIK	23	3	✓ 13.0%
18. GJAKOVË	72	9	✓ 12.5%



KOMUNAT TJERA NDËR 10%



Aneks III. Deklarimet e Zyrtarëve Komunal për ndreqe.com

Sa e përdorni ndreqe.com?

“Gjate aksioneve përdorim platformën ndreqe.com për të lokalizuar deponitë që janë të raportuara në qytetin tonë më rrethinë, dhe në bazë të mjeteve që kompania dhe ne si komunë posedojmë ndërmarrim aksion për largimin në ato vende ku janë të raportuara dhe te evidentuara”.

- **Destan Avdyli (Viti)**

“Si qasje dytësore në kohën e fundit ndiqen shumë përditësimet në platformën ndreqe.com, pasi jemi përdorues të kësaj platforme pas bashkëpunimit me ekipin e ndreqe.com. Gjithsesi verifikimi dhe aksioni për pas-trim është më i lehtë përmes platformës.”

- **Lendim Kuçi (Deçan)**

“Pa ndihmën e raportimeve evidencimi i të gjithë deponive ilegale do të ishte thuajse e pamundur. Me drejtorin kemi diskutuar për ndreqe.com lidhur me raportimet që janë në komunë të Lipjanit.”

- **Labinot Dedushi (Lipjan)**

“Raportimet e qytetarëve janë kryesisht pikënisja e aksioneve. Raportime marrim përmes telefonit, email, si dhe platformave online. Shefi i departamentit ka bisedu me drejtorin dhe e ka njoftuar për ndreqe.com. Pak a shumë drejtori e ka pa ndreqe.com sikur platformën online, mirëpo çfarëdo që na ndihmon në identifikimin e mbeturina është e mirëseardhur”

- **Saniha Bajraktaraj (Prishtinë)**

“Platforma ndreqe.com bën evidentimin e ankesave të qytetarëve në menyren më të shpejt dhe me komode të mundshme dhe si e tillë ka qen tem diskutimi me qellim zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.”

- **Samir Sylmeta (Gjakovë)**

“Mundësitë që ofron kjo platformë për identifikimin e deponive ilegale janë shumë të mira, por siç e kemi diskutuar edhe së bashku ne mendojmë që këtë platformë duhet ta shfrytëzojmë edhe për identifikimin e keqbërësve”

- **Irfan Peci (Mitrovicë)**

Ndreqe.com "ndikon në pasjen e një pasqyre të qartë për gjendjen në të cilën jemi dhe pastaj shfrytëzimi i saj, si mjet presioni tek vendimmarrësit. Është vlerësuar si mjet i dobishëm për të gjithë si për qytetarët dhe po ashtu edhe për zyrtarët përgjegjës."

- **Ilir Lulaj (Pejë)**

"Më herët kemi dal në terren dhe i kemi identifikuar deponitë që janë më me prioritetet, Tani e shfrytëzojmë edhe platformën ndreqe.com që na shërben edhe neve si zyrtarë por edhe qytetarëve."

- **Fetie Shaqiri (Skenderaj)**

A keni biseduar ndonjëherë me Kryetarin për ndreqe.com?

"Kemi biseduar me drejtorin e shërbimeve publike për mundësitë që kjo platforme na afron në evidentimin e deponive dhe për mundësinë që edhe deponi të tjera të raportuara të mund ti eliminojmë sa më parë në bashkëpunim me ju."

- **Ismajl Mehmeti (Ferizaj)**

"Kemi biseduar për numrin e deponive të larguara që kanë qene të raportuara në platforme, dhe mundësinë e intervenimit edhe në deponitë tjera që janë të raportuara nga ana e qytetarëve. Po ashtu raportet e dërguara nga ana jonë janë pjesë e diskutimit nga ana ime dhe drejtorit të shërbimeve publike."

- **Destan Avdyli (Viti)**

"Kemi biseduar [me Kryetarin] sa i përket heqjes së raportimeve të qytetarëve të komunës tone në këtë platforme, pasi që kemi raportime edhe nga viti 2017 e për të cilat jemi duke punuar për ti larguar nga platforma dhe për ti qitur si të ndrequra."

- **Kujtim Derjani (Han i Elezit)**

"Me drejtorin bashkë e përcjellim edhe ueb faqen e ndreqe.com, por edhe faqen në facebook. Jemi të kënaqur me platformën. Ju sugjerojmë që t'i bëni presion MAPL-së që gjatë vlerësimit të performancës të komunave, të gjykojnë drejtë performancën e komunës edhe përmes ndreqe-s."

- **Rizah Muçolli (Podujevë)**

"Ndreqe.com na ka ndihmuar në evidentimin e deponive ilegale të pa identifikuar më parë nga komuna dhe qasjen më të lehtë në lokacionin e deponisë. Falë platformës shumica e deponive ilegale janë identifikuar dhe larguar."

- **Lendim Kuçi (Deçan)**



Aneks IV. Kriteret e Kontratës nga Komuna e Podujevës

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Paramasa dhe parallogaria për largimin e deponve ilegale					
Nr	ndi i deponisë	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma e pozicionit
1	Podujevë (afër sillosi), largimi i shkurreve, drunjëve	m ³	120		
2	Te tregu i kafësheve	m ³	50		
3	Balloç (rrugët për Herticë dhe Shamalluk)	m ³	90		
4	Podujevë (rr. "Vëllezërit Frashëri")	m ³	30		
5	Podujevë (Rr. "Nazmi Gafurri")	m ³	60		
6	Podujevë (Rr. Shakadin Behrami)	m ³	50		
		m ³			
7	Podujevë (Rr. "Albaniku")	m ³	140		
8	Podujevë (H. Sadria)	m ³	20		
9	Rruga Podujevë-Dumnicë	m ³	130		
10	Katunisht	m ³	60		
11	Siboc	m ³	220		
12	Batllavë (te Romët)	m ³	40		
13	Bellopjë (te varrezat)	m ³	20		
14	Lupq i Poshtëm (te ura dhe bugordoll)	m ³	145		
15	Buricë	m ³	40		
16	Gërdoc (te ura)	m ³	60		
17	Gllamnik (te qeshmja dhe te Kërtokt)	m ³	50		
18	Vende të ndryshme sipas kërkesave	m ³	3020		
19	Vendosja e shenjave metalike	Copë	30		
				Gjithsej	
				TVSH (18%)	
				Totali	
<p><i>Vërejtje:</i> Mbeturinat e amvisërisë duhet të dërgohen në deponin sanitarë në fshatin Dumnicë. Mbeturinat ndërtimore duhet të ju gjendet një vend nga OE dhe të jetë i pranueshëm për organet përgjegjëse të komunës. Mbeturinat pas hjekjes me makineri pastrimi të behet edhe me dorë.</p>					

Aneks V. Kriteret e Kontratës nga Komuna e Obiliqit

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
I			
1	Hapja e kanalit dhe mbulimi me dim. 0.6x 1.5m, dhe deponimi i dheut deri ne vend te caktuar 0-7km	m	2.500,00
2	Pastrimi i mbeturinave (ineret etj) dhe deponimi I tyre deri ne vend te caktuar , 0-7km (deponive ilegale , inerte etj) , me m jete të punës :Lipker dhe Kamion	orë	100,00
3	Rrënimi i objekteve (të vjetra që paraqesin rrezik për qytatar , objekte që duhen rrënuar sepse ndërtohen të reja komuale, dhe ndertimet pa leje etj), me mjete të punës :Lipker dhe kamion	orë	100,00
4	Rrënimi i objekteve (të vjetra që paraqesin rrezik për qytatar , objekte që duhen rrënuar sepse ndërtohen të reja komuale etj), me mjete të punës :eskavator me hillt dhe kamion (bartja dhe deponimi i materilait 0-7km)	orë	50,00
5	Furnizimi , shtritja e materialit me zhvorr natyral(per gypa)	m³	150,00
6	Furnizimi dhe vendosja e gypave të betoit me diameter 400mm.	m'	50,00
7	Pastrimi dhe formësimi I kanaleve të prrocakve/shtrat të lumit ekzistuese me dimeione 1.5 deri 2.5 gjersia me 1.5-deri 2 thellësi. Dhe largimi I materialit të pa nevojshëm deri ne deponi 0-7km	m'	500,00

Katalogimi në botim - **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

628.54(084.2)

Rritja e efikasitetit në menaxhimin e mbeturinave përmes ndreqe.com / përgatitur Jetmir Bakija. – Prishtinë : Democracy Plus, 2018. – 29 f. : ilustr.; 21 cm.

1.Bakija, Jetmir

ISBN 978-9951-758-09-3



ndreqe është platformë online që mbledhë ankesat e qytetarëve për shërbime publike komunale dhe i portretizon në një hartë interaktive. Platforma u mundëson qytetarëve të raportojnë lehtë dhe shpejt ankesat, ndërsa institucioneve komunale iu mundëson kanalizimin e këtyre kërkesave në një vend lehtë të qasshëm.

Aktualisht, përmes Platformës ndreqe mund të raportohen këto kategori të problemeve: mbeturina, ujëra të zeza, gropa në rrugë, ndriçim publik, trotuar i dëmtuar, shenja të rrugës dhe pengesa për persona me aftësi të kufizuar.

Ankesat e raportuara në ndreqe dërgohen për t'u rregulluar tek zyrtarët përgjegjës të komunave. Secili qytetar mund të shohë ankesat e raportuara, mund të përditësoj ato apo abonohet për njoftime. Përveç kësaj, ndreqe krijon një atmosferë të pjesëmarrjes qytetare, ku qytetarët mund të përfshihen drejtpërdrejtë në ankesa tek qeverisja lokale. Iu mundëson qytetarëve të raportojnë lehtë dhe shpejt ankesat për shërbime publike në lagjet dhe fshatrat e tyre.

ISBN 978-9951-758-09-3

